



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1471 Prot

Shkodër, më 31.01.2023

LËNDA: Dërgohet projekt-vendim dhe relacion

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkangjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin
“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMEVE
AFATMESME TË TË ARDHURAVE TË BASHKISË SHKODËR PËR VITET
2024-2026”

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë,

Me respekt

KRYETAR

Bardh SPAHIA

Me vendim Delegimi

ZV/KRYETAR

Tonin **VEDAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

"PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMEVE DHE
PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË ARDHURAVE TË BASHKISË SË
SHKODRËS PËR VITET 2024 - 2026"

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 8, nenin 9, nenet 34-37, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; kreu III, dhe nenit 34, të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore".

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2024 - 2026, sipas dokumentit pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Bardh SPAHIA

Me vendim delegimi

ZV/KRYETAR

Tonin DEJDAJ



Zv. Kryetar

Toni Sedo

Zv. Kryetar

Drejtoria e te Ardhurave

Giorgi Musli

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Gene Hoxha 2023

Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekës se
investimeve të Infrastrukturës

Alfred Sulata

Drejtoria e Ndhimes Ekonomike

Flavio Malocaj

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve Mbështetëse

Arslita Rexhep

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
trajtimit të AMTP

Alban Selja

Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të
Territorit

Brunilda Krasa

Policia Bashkiake

GENT NERANI

Zv. Kryetar

Drejtoria e Financës

Plator Myc

Drejtoria Juridike

02

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe
Sportit

Veronica Hoxha

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe
Strehimit

Lucie Bardeli

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe
Menaxhimit të Ujërave

Fida Mulla

Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,
Koordinimit të Investimeve

Arjan

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Rioltan Sololi

Drejtoria e Turizmit

Joseta Kosta

Administratori Njësia Administrative Postribë

Valdet Bushaj

Administratori Njësia Administrative Dajç

Ervin Peleji

Administratori Njësia Administrative Rrethina

Egon Sullaj

Administratori Njësia Administrative Guri i Zi

Pjeter Marku

Administratori Njësia Administrative Pult

Tom Mance

Administratori Njësia Administrative Velipojë

Artin Koci

Administratori Njësia Administrative Bërdicë

Aleksandra Paskula

Administratori Njësia Administrative Ana e Malit

Arben Cuni

Administratori Njësia Administrative Shalë

Getit Amari

Administratori Njësia Administrative Shosh

Ndora Ashta

[Signature]

**Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe
parashikimeve afatmesme të të ardhurave të
Bashkisë së Shkodrës për vitet 2024 - 2026**

Përmbajtja

TË ARDHURAT E VETA TË BASHKISË	5
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA VENDORE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE	16
TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE	18
Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	19
Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.....	19
Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel.....	22
Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë	23
Të ardhura nga Taksa e Tabelës	24
TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA	25
Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura.....	26
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.....	26
Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare	26
Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale.....	26
TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE.....	26
Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit	27
Taksapaguesit biznese dhe institucione.....	30
Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative	34
Të ardhura nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit.....	35
Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike.	35
Të ardhura nga Tarifa për dhënie liçensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve.....	35
Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave.....	35
Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri.	35
Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike.....	35
Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet).	36
Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.	36
TË ARDHURA TË TJERA	37
Të ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat.....	38
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë.....	38
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve.....	39
Të ardhura nga donacionet	39
Të ardhura dhe grantet ndërkombëtare.....	39
Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre	40

Lista e tabelave

Tabela 1 Të ardhurat e veta.....	7
Tabela 2 Të ardhurat e veta për vitet 2024-2026 sipas klasifikimit ekonomik.....	10
Tabela 3 Planifikimi i të ardhurave për vitet 2024-2026 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë.....	16
Tabela 4 Të ardhurat nga taksat vendore.....	18
Tabela 5 Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve sipas kategorizimit.....	19
Tabela 6 Kapaciteti i banesave të taksueshme.....	20
Tabela 7 Të dhena mesatare sipërfaqe e ndërtese për taksapagues sipas llojit, familiar dhe biznes.....	21
Tabela 8 Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme, sipas kategorisë së bonitetit.....	21
Tabela 9 Efekti ekonomik i uljes së taksës së ndërtesës dhe tokës bujqësore.....	22
Tabela 10 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel.....	23
Tabela 11 Efekti i lehtësive fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë.....	24
Tabela 12 Të ardhurat nga taksat e ndara sipas llojit.....	25
Tabela 13 Të ardhurat nga tatifat vendore sipas llojit.....	27
Tabela 14 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve.....	28
Tabela 15 Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve.....	29
Tabela 16 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese.....	30
Tabela 17 Kapaciteti i bizneseve te vogla sipas natyres se tyre.....	32
Tabela 18 Kapaciteti i bizneseve te medha sipas natyres se tyre.....	33
Tabela 19 Efekti ekonomik i lehtësive tek pastrimi, ndriçimi dhe gjelbrimi për familjet.....	34
Tabela 20 Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social.....	36
Tabela 21 Të ardhurat e tjera sipas llojit të të ardhurës.....	37

Lista e Grafikëve

Grafik 1 Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2024-2026.....	8	
Grafik 2 Pesha e çdo taksë dhe tarifë në parashikimin e të ardhurave.....	9	
Grafik 3 Të ardhurat nga taksat vendore.....	18	
Grafik 4 të ardhurat mbi tokën bujqësore sipas kategorive të tokës.....	22	
Grafik 5 Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave.....	27	
Grafik 6 Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Shkoder	Grafik 7 Kapacitetet fiskale per taksapaguesit familja	29
Grafik 8 Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familja sipas njësive administrative.....	30	
Grafik 9 Shpërndarja e biznesit në Bashkinë Shkodër.....	31	
Grafik 10 Raporti i bizneseve sipas xhiros.....	32	
Grafik 11 Kapacitetet e biznesit të vogël.....	32	
Grafik 12 Kapaciteti i biznesit te madh.....	34	
Grafik 13 Pesha e të ardhurave e tjera sipas llojit.....	38	

Të ardhurat e veta të bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, dhe të ardhurat e tjera

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, te ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 ”Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër“, të ndryshuar;
4. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, të përditësuar, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë së Shkodrës ndër vite, janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet. Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime konsultative gjithpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.

Paketa fiskale e Bashkisë Shkodër, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- ✓ Politikat incentivuese në taksa:
 - Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.
 - Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
 - Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.
 - Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore.
 - Ulje deri në nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukturë.
- ✓ Politikat incentivuese dhe uljet në nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:
 - Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale
 - Tarifa minimale deri në zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale

- Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kriterëve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore
- Tarifa të ulëta pastrimi, dhe pa tarifa të tjera për ambulancat


Bashkia Shkodër, tashmë, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksa pagesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.

Bashkia Shkodër ka kërkuar lidhjen e të dhënave për pasuritë e paluajtshme që disponon ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës) me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Tabela 1. Të ardhurat e veta

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Të ardhurat e veta / mijë lekë								
	682,069	659,778	762,935	882,226	876,066	887,300	887,400	887,625
Të ardhura nga taksat vendore	268,810	233,917	259,082	344,708	348,913	356,369	362,569	362,586
	94,614	126,722	164,666	118,568	127,757	127,757	129,757	129,757
Të ardhura nga taksat e ndara								
	287,611	274,154	287,445	353,967	369,425	373,203	365,103	365,210
Të ardhura nga tarifat vendore								
Të ardhura të tjera +grante nderkombetare+donacione	31,034	24,985	51,742	64,983	29,971	29,971	29,971	30,072
Grante nderkombetare me sistem të pjesshëm thesari	7,596	10,815	0	86,661	40,860	2479	770	0
Të ardhurat total	689,665	670,593	762,935	968,887	916,926	889,779	888,170	887,625

Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2024-2026




Grafik 1 Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2024-2026

Të ardhurat e veta, që mblidhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2024-2026 parashikohen që të kenë një trend të njëjtë për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2024-2026 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 22%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 14%, tarifa për pastrimin që zë rreth 20%, taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura që zë rreth 10%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 4%, tarifa të tjera ku përfshihen tarifat nga institucionet kulturore dhe tarifa administrative zëzë rreth 9%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 79% të planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

Pesha e çdo taksë dhe tarifë në parashikimin e të ardhurave



Grafik 2 Pesha e çdo taksë dhe tarifë në parashikimin e të ardhurave

Planifikimi i të ardhurave të veta për vitet 2024-2026 i kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor paraqitet si më poshtë:

Tabela 2 Të ardhurat e veta për vitet 2024-2026 sipas klasifikimit ekonomik

	000/leke					
	Fakti	Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Plani	Plani
	2020	2021	2022	2023	2024	2025
A	670,593	762,298	970,365	916,926	889,779	888,170
A.1	233,917	259,083	344,708	348,913	356,369	362,569
A.1.1	9,423	7,113	2,238	4,000	3,000	4,000
A.1.2	135,535	160,407	187,954	188,186	196,286	198,286
A.1.2.1	117,505	138,703	167,173	152,900	160,000	162,000
A.1.2.2	4,698	8,283	6,226	21,736	21,736	21,736
A.1.2.3	13,332	13,421	14,555	13,550	14,550	14,550
A.1.2.4	-	-	-	-	-	-
A.1.3	7,380	12,967	18,408	20,800	20,800	20,900
A.1.4	69,673	65,687	121,182	119,607	121,283	123,483
A.1.5	11,906	12,909	14,926	16,320	15,000	16,000

A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	126,722	164,667	118,568	127,757	127,757	127,757	127,757	127,757	129,757	129,757	129,757	129,757	129,757	129,757	129,757	129,757	129,757	129,757
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	12,444	17,555	18,935	15,722	15,722	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	85,720	109,324	70,780	90,000	90,000	79,722	79,722	79,722	81,722	81,722	81,722	81,722	81,722	81,722	81,722	81,722	81,722	81,722
A.2.3	Taksa e rentës minerare	13	11	6	35	35	35	35	35	35	35	35	35	35	35	35	35	35	35
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	28,545	37,777	28,847	22,000	22,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000	29,000
A.2.5	Taksa të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	274,154	287,445	353,967	369,425	369,425	373,203	373,203	373,203	365,103	365,103	365,210	365,210	365,210	365,210	365,210	365,210	365,210	365,210
A.3.1	Tarifa me menaxhimin te mbetjeve	149,117	157,588	183,336	171,964	171,964	181,164	181,164	181,164	182,164	182,164	182,164	182,164	182,164	182,164	182,164	182,164	182,164	182,164
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	72,661	62,011	72,620	75,500	75,500	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700	75,700
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	715	721	504	464	464	464	464	464	464	464	464	464	464	464	464	464	464	464
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	75,741	94,856	110,212	96,000	96,000	105,000	105,000	105,000	106,000	106,000	106,000	106,000	106,000	106,000	106,000	106,000	106,000	106,000
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik		30,902	32,719	42,339	52,943	53,043	53,043	53,043
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet		20,911	20,449	25,422	32,080	32,080	32,080	32,080
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	148		138	96	163	163	163	163
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	9,842		12,132	16,821	20,700	20,800	20,800	20,800
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin		19,819	20,110	23,486	23,567	23,667	23,667	23,667
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	9,665		7,967	10,601	9,907	9,907	9,907	9,907
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	147		138	79	160	160	160	160
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	10,007		12,005	12,806	13,500	13,600	13,600	13,600
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë		64,566	61,311	87,583	90,066	84,144	75,044	75,151
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	3,146		5,707	13,703	4,500	4,500	4,500	4,500
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e licensave, lejeve e autorizimeve		-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit		-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	797		573					
A.3.5.5	Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit	909		866	1,513	991	869	869	875
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendparkime publike	3,449		5,528	4,919	3,000	5,000	5,000	5,000
A.3.5.7	Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	9,478		6,543	17,649	30,000	22,000	12,000	12,000

A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	123	11	459	1,900	1,900	1,900	1,900	1,900
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksjja	1,314	1,591	1,487	760	860	860	860	860
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	45,350	40,470	47,652	47,000	47,100	48,000	48,100	48,100
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksove (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	195	500	500	500	500	500
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankaand etj	-	22	6	15	15	15	15	16
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	9,750	15,717	17,214	26,885	27,185	27,185	27,185	27,185
A.3.6.1	Biblioteka	3	12	9	15	15	15	15	15
A.3.6.2	Muzeumet	590	1,340	2,246	2,620	2,620	2,620	2,620	2,620
A.3.6.3	Teatri	32	679	306	2,200	2,500	2,500	2,500	2,500
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.5	Pallati i sportit	152	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	10	-	21	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	63	69	17	50	50	50	50	50
A.3.6.8	Kopshtet	5,927	9,055	9,846	15,000	15,000	15,000	15,000	15,000
A.3.6.9	Çerdhet	2,973	4,562	4,769	7,000	7,000	7,000	7,000	7,000

A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	-	-	-	9	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4	Të Ardhurat e Tjera	35,800	51,103	153,122	70,831	32,450	30,741	30,741	30,072	30,072	30,072	30,072	30,072
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	1,804	2,802	3,668	6,500	6,500	6,500	6,500	6,500	6,500	6,500	6,500	6,500
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	215	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	12,100	21,768	17,996	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
A.4.8	Sekuestri dhe Zhdëmtime	5,011	1,396	1,668	3,100	3,100	3,100	3,100	3,100	3,100	3,100	3,100	3,200
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	11,509	210	88,139	40,860	2,479	770	770	770	770	770	770	770


Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë Administrative Shkodër, ose 71% të planit total të të ardhurave.

Tabela 3 Planifikimi i të ardhurave për vitet 2024-2026 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë

Viti	Njësia Administrative Qendër										Njësia Administrative të tjera							
	Totali	Shuma	Lagje nr. 1	Lagje nr. 2	Lagje nr. 3	Lagje nr. 4	Lagje nr. 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethina
Plan 2024	887,300	633,615	148,725	131,250	128,420	135,812	89,408	253,685	1,908	1,525	2,517	12,404	20,141	23,056	119,285	17,209	10,962	44,678
Plan 2025	887,400	633,715	148,745	131,270	128,440	135,832	89,428	253,685	1,908	1,525	2,517	12,404	20,141	23,056	119,285	17,209	10,962	44,678
Plan 2026	887,625	633,764	148,973	131,486	127,647	136,052	89,606	253,861	1,910	1,526	2,518	12,413	20,156	23,072	119,366	17,221	10,970	44,709

Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative Administrative



Grafik Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative Administrative

Të ardhurat nga Taksat Vendore

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njëjësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.


Për vitet 2024-2026 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë rreth 40% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

Tabela 4 Të ardhurat nga taksat vendore

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	356,369	362,569	362,586
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	2,000	3,000	3,000
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	1,000	1,000	1,000
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	196,286	198,286	198,286
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	20,800	20,800	20,900
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	121,283	123,483	123,400
Të ardhura nga taksa e tabelës	15,000	16,000	16,000

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 54% te totalit të të ardhurave nga taksat vendore, dhe më pas vijnë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me 35%, taksa e tabelës me 5% dhe taksa e fjetjes në hotel me 6%.

Të ardhura nga taksat vendore



Grafik 3 Të ardhurat nga taksat vendore

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesa banimi dhe ndërtesa biznesi)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2024-2026 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këste të pagesave për familjarët,
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritsëm me institucionin Agjencia e Kadastrës Shtetërore.

Kapaciteti i pronës së taksueshme

Bazuar në regjistrat aktual, në total, sipërfaqja ndërtesave që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është rreth 590,970 m².

Bizneset tregti dhe shërbime kanë rreth 81% të sipërfaqes totale të bizneseve të taksueshme.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për sipërfaqet e taksueshme të ndërtesave në pronësi të bizneseve, sipas Njësi Administrative:

Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve

Tabela 5 Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve sipas kategorizimit

Bashkia Shkodër	Total Sip. ndërtesa biznesi m ²	Sip. Taksueshme biznesi tregti-shërbime m ²	Sip. Taksueshme biznesi prodhimi m ²
NjA Qendër	449,258	351,663	97,595
Lagjia nr.1	84,197	77,547	6,650
Lagjia nr.2	103,501	63,138	40,363
Lagjia nr.3	128,832	92,840	35,992
Lagjia nr.4	88,018	82,430	5,588
Lagjia nr.5	44,710	35,708	9,002

NjA të tjera	141,712	129,636	12,076
NjA Pult	12	12	0
NjA Shosh	133	133	0
NjA Shalë	5171	4497	674
NjA Postribë	6548	6373	175
NjA Guri i Zi	12775	7581	5,194
NjA Bërdicë	13605	12355	1,250
NjA Velipojë	4622	4554	68
NjA Velipojë Plazh	54878	54878	0
NjA Dajc	3587	2761	826
NjA Ana e Malit	3158	2680	478
NjA Rrethinat	37223	33812	3,411
TOTALI	590,970	481,299	109,671

Tabela 6 Kapaciteti i banesave të taksueshme

Bashkia Shkodër	Total sipërfaqe ndërtesa banimi m² (përfshirë lehtësimin)
NjA Shkodër	2,182,829
Lagjia nr.1	482,253
Lagjia nr.2	456,871
Lagjia nr.3	406,108
Lagjia nr.4	456,871
Lagjia nr.5	380,726
NjA të tjera	1,425,227
Pult	7,775
Shosh	5,348
Shalë	8,275
Postribë	96,289
Guri i Zi	128,385
Bërdicë	160,481
Velipojë	355,345
Dajc	192,578
Ana e Malit	64,193
Rrethinat	406,558
TOTALI	3,608,056


Tabela 7 Të dhena mesatare sipërfaqe e ndërtese për taksapagues sipas llojit, familiar dhe biznes

Bashkia Shkodër	Total Sipërfaqe truall i taksueshëm, m ²	Truall taksapagues familjar, m ²	Truall taksapagues biznes, m ²
NjA Shkodër	2,903,629	2,343,776	559,853
Lagjia nr.1	611,491	506,997	104,494
Lagjia nr.2	640,634	494,334	146,300
Lagjia nr.3	602,145	443,050	159,095
Lagjia nr.4	571,623	481,671	89,952
Lagjia nr.5	477,736	417,724	60,012
NjA të tjera	2,319,738	2,060,995	258,743
Pult	10,882	10,882	0
Shosh	7,138	6,938	200
Shalë	21,265	11,910	9355
Postribë	171,357	151,955	19,402
Guri i Zi	219,276	202,606	16,670
Bërdicë	300,727	257,791	42,936
Velipojë	444,858	383,053	61,805
Dajc	310,623	300,779	9,844
Ana e Malit	109,437	101,936	7,501
Rrethinat	724,175	633,145	91,030
TOTALI	5,101,256	4,404,771	696,485

Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme

Tabela 8 Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme, sipas kategorisë së bonitetit

Nr	Bashkia Shkodër	Kat I	Kat II	Kat III	Kat IV	Kat V	Kat VI	Kat VII-X
1	NjA Pult	-	-	-	409	-	-	-
2	NjA Shosh	-	-	-	-	314	-	-
3	NjA Shalë	-	-	-	-	416	418	-
4	NjA Postribë	-	-	-	-	-	1.030	-
5	NjA Guri i Zi	-	-	-	1965	-	-	-
6	NjA Bërdicë	-	-	-	2151	-	-	-
7	NjA Velipojë	-	-	-	2949	-	-	-
8	NjA Dajc	-	-	2.135	-	-	-	-
9	NjA Ana e Malit	-	-	886	887	-	-	-
10	NjA Rrethinat	-	-	-	-	2.481	-	-
	TOTALI	-	-	3.021	8.361	3.211	1.448	-



Grafik 4 të ardhurat mbi tokën bujqësore sipas kategorive të tokës

Efekti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së pronës.

Bashkia Shkodër ka synuar mbajtjen e taksave në nivele të ulëta, deri në kufijtë e lejuarligjor. Kështu, taksa e banesës dhe e ndërtesave për qëllime biznesi është ulur 30% në Njësitë Administrative, me një efekt prej 1,536 mijë Lekë në vit.

Taksa e tokës bujqësore është ulur deri në kufirin e lejuar 30% nga referenca ligjore. Efekti ekonomik i uljes së taksës së tokës bujqësore është 9,607 mijë Lekë/vit. Në total, efekti ekonomik i uljes së taksave të pronës është 11,143 mijë Lekë në vit.

Tabela 9 Efekti ekonomik i uljes së taksës së ndërtesës dhe tokës bujqësore

	Potenciali	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Efekti fiskal mesatar
Efekti i lehtësive fiskale /000 Lekë	192,946	181,736	181,736	181,736	11,143
Banesa	77,603	76,555	76,555	76,555	1,048
Ndërtesa biznesi	84,000	83,445	83,445	83,445	488
Tokë bujqësore	31,343	21,736	21,736	21,736	9,607

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Planifikimi i të ardhurave është bërë ju referuar kapacitetit aktual dhe parashakimit të zgjerimit të tij, rritjes së numrit të njësive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit.

Tabela 10 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Të dhënat e programit / Vitet	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele	282,229	105,425	214,286	229,928	285,714	285,714	285,714	285,714
Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel në 000/Lekë	19,756	7,380	12,967	20,500	20,800	20,800	20,800	20,800

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Bashkia Shkoder, planin e të ardhurave ng ataksa e ndikimi tnë infrastrukture e ka bazuar në:

- Ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është përlogaritur duke marrë për bazë parashikimin e lejeve për ndërtime të reja në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me VKB nr.: 27, datë 20.04.2017 “Për miratimin e planit të zhvillimit të territorit dhe rregulloren e zbatimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër” dhe me vendimin e KKT nr.5 date 16.10.2017 “ Per miratimin e planit te pergjithshem vendor si dhe në nismat Publike për hartim e PDV-ve, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, në disa njësi strukturore.

Kjo në mbështetje të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, si dhe në interesin publik;

- Shlyerjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë të objekteve të legalizuara për objektet në process legalizimi, si dhe detyrime tatimore të pambledhura në kohë, prej më pak se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me ligjin. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga Agjencia e Kadastres Shteterore.

Efekti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë

Për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e

turizmit, industrisë apo për përdorim public, Bashkia Shkodër ka ulur nivelin e taksës nga 8% në 4% të çmimit të shitjes së objektit.

Si dhe për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, Bashkia Shkodër ka ulur nivelin e taksës nga 3% në 2% të vlerës së investimit për Njësitë Administrative .

Efekti ekonomik në total është rreth 97,500 mijë Lekë në vit.

Tabela 11 Efekti i lehtësive fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë

	Potenciali	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Efekti fiskal mesatar
Efekti i lehtësive fiskale /000 Lekë	197,500	100,000	100,000	100,000	97.500
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrise apo për përdorim publik.	160,000	80,000	80,000	80,000	80,000
Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	37,500	20,000	20,000	20,000	17,500

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Parashikimi i të ardhurave bazohet në numrin e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese dhe kërkesën për vendosje tabela reklamimi në akse kryesore rrugore.

Të ardhurat nga Taksat e Ndarë

Tabela 12 Të ardhurat nga taksat e ndarë sipas llojit

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	127,757	129,757	129,957
Të ardhura nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	19,000	19,000	19,000
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	79,722	81,722	81,722
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	35	35
Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	29,000	29,000	29,000

Në përputhje me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. të ardhurat nga taksat e ndarë, zënë 15% të totalit të të ardhurave të veita të Bashkisë Shkodër.

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Planifikimi i të ardhurave bëhet referuar numrit të automjeteve si dhe në eksperiencën e viteve të kaluara për nivelet e arkëtimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor .

Bashkia Shkodër përfiton 28 % të ardhura nga kjo taksë, e cila transferohet çdo muaj nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Planifikimi bëhet nga të dhënat e agjentit tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara referuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite.

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Planifikimi i të ardhurave i është referuar të dhënave statistikore për të punësuarit në territorin e Bashkisë Shkodër, si dhe raporteve vjetore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Detyrimi ligjor për këtë taksë të ndarë ka filluar në vitin 2018, por nuk është përmbushur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për 2 vite rresht.

Në vitin 2020, u transferua një shumë në favor të Bashkisë Shkodër në muajin Tetor 2020. Mbeten pa u transferuar shumat për vitet 2018 dhe 2019. Pastaj në vitin 2022 kemi një arkëtim me vlerë 28,847 mijë lek. Parashikimi është bërë me rezerva, duke mos patur shifra të sakta zyrtare të sjella nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.

Të ardhurat nga Tarifatat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; dhënie licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikën dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.


Për vitin 2024-2026 të ardhurat e parashikuara nga tarifatat përbëjnë rreth 42% të të ardhurave të veta.

Tabela 13 Të ardhurat nga tatifat vendore sipas llojit

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	373,203	365,103	365,210
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	181,164	182,164	182,164
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	53,043	53,043	53,143
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	23,667	23,667	23,767
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	115,329	106,229	106,136

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifatat vendore e zënë të ardhurat nga tarifatat për ofrimin e shërbimeve publike të pastrimit e largimit të mbeturinave me 47% të totalit të tarifave, duke qenë edhe një nga aktivitetet kryesore në funksionin e shërbimeve publike, të gjelbrimit me 6%, të ndriçimit publik me 14%, të shërbimit administrativ të bashkisë me 32 %, ku bëjnë pjesë tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj

Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave të veta



Grafik 5 Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave

Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Parashikimi i të ardhurave nga tarifatat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimit, bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësisve takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës takapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me takapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Kontribuesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësisve administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave për takapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak.

Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 41,008 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, rreth 86%.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

Tabela 14 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)			
Nr	Bashkia Shkodër	Familje	Biznese
I	Njësia Administrative Shkodër	21,253	4,497
1	Lagjia nr.1	4,745	1,295
2	Lagjia nr.2	4,231	848
3	Lagjia nr.3	4,399	998
4	Lagjia nr.4	4,698	958
5	Lagjia nr.5	3,180	398
II	Njësi Administrative të tjera	14,172	1,086
1	NjA Pult	334	1
2	NjA Shosh	80	4
3	NjA Shalë	477	25
4	NjA Postribë	1609	92
5	NjA Guri i Zi	1907	117
6	NjA Bërdicë	1425	135
7	NjA Velipojë	1270	252
8	NjA Dajç	1152	55
9	NjA Ana e Malit	1017	66
10	NjA Rrethinat	4901	339
	TOTALI	35,425	5,583

Taksapaguesit familjarë

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente sipas Censurit, si dhe lehtësive fiskale të miratuara.


Në total numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 35,425. Në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i këtyre familjeve arrin në 8,878 familje si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj. Ato zënë 25% të numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Shkodër.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësive Administrative:


Tabela 15 Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve

Nr	Bashkia Shkodër	Totali i familjeve	Familje me taksa/tarifatëplota	Familje me lehtësi fiskale	Me lehtësi fiskale: Pensionistë, invalidë etj.	Me lehtësi fiskale: nd.ekonomike.
I	NjA Qendër	20,415	16,540	3,875	3,658	217
1	Lagjia nr.1	4745	3,983	762	710	52
2	Lagjia nr.2	4231	3,861	370	350	20
3	Lagjia nr.3	4399	3,595	804	792	12
4	Lagjia nr.4	4698	3,027	1,671	1,571	100
5	Lagjia nr.5	2342	2,074	268	235	33
II	NjA të tjera	15,010	10,007	5,003	2,625	2,378
1	NjA Pult	333	211	605	58	219
2	NjA Shosh	68			0	65
3	NjA Shalë	415			30	233
4	NjA Postrisë	1793	948	845	304	541
5	NjA Guri i Zi	2090	1,299	791	422	369
6	NjA Bërdicë	1543	1,023	520	321	199
7	NjA Velipojë	1322	1,123	199	143	56
8	NjA Dajç	1144	871	273	232	41
9	NjA Ana e Malit	1074	856	218	132	86
10	NjA Rrethinat	5228	3,676	1552	983	569
	TOTALI	35,425	26,547	8,878	6,283	2,595

Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Shkodër




Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familjar



Grafik 6 Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Shkodër Grafik 7 Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familjar

Kapacitetet fiskale per taksapaguesit familjar sipas Njësive Administrative



Grafik 8 Kapacitetet fiskale për taksapaguesit familjar sipas njësive administrative

Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 5,583. Biznesi i vogël zë rreth 73% të numrit total të bizneseve.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset dhe institucionet, sipas Njësive Administrative:

Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese


Tabela 16 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr	Bashkia Shkodër	Totali	Biznes i vogël	Biznes i madh	Institucione
I	NjA Qendër	4,504	3,279	1,172	53
	Lagjia nr.1	1,287	982	291	14
	Lagjia nr.2	852	594	249	9
	Lagjia nr.3	1,002	702	289	11


Lagjia nr.4	957	688	252	17
Lagjia nr.5	406	313	91	2
II NjA të tjera	1079	780	294	5
NjA Pult	1	1	0	0
NjA Shosh	4	4	0	0
NjA Shalë	25	22	3	0
NjA Postribë	89	72	17	0
NjA Guri i Zi	116	91	24	1
NjA Bërdicë	132	79	53	0
NjA Velipojë	249	201	48	0
NjA Dajc	54	38	16	0
NjA Ana e Malit	66	47	19	0
NjA Rrethinat	343	225	114	4
TOTALI	5,583	4,059	1,466	58

Shpërndarja e biznesit në Bashkinë Shkodër



Grafik 9 Shpërndarja e biznesit në Bashkinë Shkodër

Raporti i bizneseve sipas xhiros



Grafik 10 Raporti i bizneseve sipas xhiros


Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 88% ndaj totalit të bizneseve të vegjël.

Tabela 17 Kapaciteti i bizneseve te vogla sipas natyres se tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TE VOGLA SIPAS NATYRES SE TYRE

Nr	Bashkia Shkodër	Biznesi i vogël	Nga kjo :			
			Njësi tregtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione te lira	Ambulantë
I	NjA Shkodër	3,381	2,962	66	242	111
	Lagjia nr.1	984	905	20	48	11
	Lagjia nr.2	604	521	14	56	13
	Lagjia nr.3	709	593	11	33	72
	Lagjia nr.4	760	638	14	100	8
	Lagjia nr.5	324	305	7	5	7
II	NjA të tjera	678	613	43	18	4
	Pult	1	1	0	0	0
	Shosh	4	4	0	0	0
	Shalë	22	22	0	0	0
	Postribë	53	45	6	2	0
	Guri i Zi	87	80	4	3	0
	Bërdicë	77	68	9	0	0
	Velipojë	180	170	3	3	4
	Dajc	37	32	4	1	0
	Ana e Malit	44	41	2	1	0
	Rrethinat	173	150	15	8	0
	TOTALI	4,059	3,575	109	260	115

Kapacitetet e biznesit të vogël



Grafik 11 Kapacitetet e biznesit të vogël


Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e mëdha, vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 66% ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

Tabela 18 Kapaciteti i bizneseve të mëdha sipas natyrës së tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TË MËDHA SIPAS NATYRËS SË TYRE

	Bashkia Shkodër	Biznesi i madh	Nga kjo :					Institucione
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi tregtare për tregëtim karburanti	Njësi prodhimi	Subjekte ndërtimi	Ente shtetërore, OJF, etj.	
I	NjA Shkodër	1,270	883	22	110	73	129	53
	Lagjia nr.1	301	225	12	15	16	19	14
	Lagjia nr.2	269	190	3	41	15	11	9
	Lagjia nr.3	312	217	2	25	19	38	11
	Lagjia nr.4	268	188	2	13	14	34	17
	Lagjia nr.5	120	63	3	16	9	27	2
I	NjA të tjera	254	164	23	39	14	9	5
	Pult	0	0	0	0	0	0	0
	Shosh	0	0	0	0	0	0	0
	Shalë	3	2	0	1	0	0	0
	Postribë	17	9	4	3	1	0	0
	Guri i Zi	23	8	1	8	3	2	1
	Bërdicë	36	20	5	8	3	0	0
	Velipojë	41	31	2	3	3	2	0
	Dajç	15	10	1	4	0	0	0
	Ana e Malit	16	13	2	1	0	0	0
	Rrethinat	103	71	8	11	4	5	4
	TOTALI	1,524	1,047	45	149	87	138	58

Kapaciteti i biznesit te madh



Grafik 12 Kapaciteti i biznesit te madh

Efekti ekonomik i lehtësive të tarifave për familjet

Bashkia Shkodër aplikon lehtësi tek tarifat vjetore të pastrimit, ndriçimit dhe Gjelbrimit 50% për familjet që kanë statusin e pensionistit, Invalidit, Paraplegjik, Tetraplegjik etj, dhe tarifa zero kur janë përfitues të ndihmës ekonomike. Efekti ekonomik mesatar i këtyre lehtësive llogaritet në total 37,020 mijë Lekë në vit.

Tabela 19 Efekti ekonomik i lehtësive tek pastrimi, ndriçimi dhe gjelbrimi për familjet

	Potenciali	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Efekti fiskal mesatar
Efekti i lehtësive fiskale /000 Lekë	154,707	117,687	117,687	117,687	37,020
<i>Pastrimi</i>	100,513	75,700	75,700	75,700	24,813
<i>Ndriçimi</i>	41,442	32,080	32,080	32,080	9,362
<i>Gjelbrimi</i>	12,752	9,907	9,907	9,907	2,845

Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje ndërtimi, zhvillimi, kontrole dhe verifikime etj si efekt i rritjes së aplikimeve nga qytetarët, planfikohet rritje prej 3% të ardhura në vit, referuar trendit të rritur të kërkesave.

Të ardhura nga Tarifat e liçensimit te veprimtarive te transportit

Plani i të ardhurave të parashikuara, bazohet tek trendi i aplikimeve për rinovimin e liçencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që pajisen me liçensën dhe certifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike.

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një liçensë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi, mikrobuzë, autobusë etj.

Të ardhura nga Tarifa për dhënie liçensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve.

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ky zë parashikon një shifër konstante, duke u bazuar tek trendi i aplikimeve për rinovimin e liçencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë karburant, të cilave u përfundon afati 5- vjeçar i liçencës.

Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave.

Të ardhurat e parashikuara bazohen në trendin e aplikimeve të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri.

Të ardhurat e parashikuara bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, sipas VKM, nr.607, datë 29.07.2020“Për tarifën për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Sipas kësaj dispozite ligjore, tarifën nuk aplikohen kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria

Të ardhura nga Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kërkesës në vite dhe trendit në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë si dhe VKM për stacionet e plazhit.

Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet).

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave brenda juridiksionit të Bashkisë. Bashkia Shkoder është duke bërë regjistrimin e infrastrukturës pasive e cila mundëson vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ne regjistrin elektronik të të dhënave në sistemin ATLAS. Ne zbatim të Ligjit nr.120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Vendimit nr.851 datë 07.12.2016 “Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të Bashkitë”, Ligji Nr. 9918 datë, 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si edhe të Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bashkia konsiderohet si operator rrjeti, pasi ka në pronësi apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, të cilat mundësojnë vendosjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.

Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të këtyre institucioneve, si dhe realizimit ndër vite, me një rritje mesatarisht prej 0.2%.

Tabela 20 Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social.

Te dhenat e programeve	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Nr femije në kopshte	1681	1862	1862	2000	2000	2000	2000	2000
Numri i fëmijevë të shërbyer në çerdhe	172	190	310	310	310	310	310	310
Numri i aktiviteteve kulturore gjithsej	65	50	71	71	71	71	71	71
Nr i vizitoreve në muzeume	12035	2950	12500	12500	12500	12500	12500	12500
Nr i nxenesve që perfitojne ushqim me pagese	11	3	7	7	7	7	7	7

Efekti ekonomik i lehtësive të tarifave të kopshteve dhe çerdheve

Bashkia Shkodër po aplikon lehtësi tek tarifat vjetore të kopshteve dhe çerdheve për fëmijët me aftësi ndryshe. Efekti ekonomik mesatar i këtyre lehtësive llogaritet në total 2,299 mijë Lekë në vit.

Tabela 21 Efekti ekonomik i lehtësive të kopshteve dhe çerdheve


Efektet financiare të lehtësive të tarifave të kopshteve dhe çerdheve					000/leke
Emertimi	Nr. I fëmijeve	kuotë/ditë	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar
Kopshte	200	180	16,177	15,000	1,177
Çerdhe	350	140	8,122	7,000	1,122
TOTAL			24,299	22,000	2,299

Te ardhura të tjera

Tabela 21 Të ardhurat e tjera sipas llojit të të ardhurës

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
TË ARDHURA TË TJERA	29,971	29,971	29,971
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	20,000	20,000	20,000
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	6,500	6,500	6,500
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	3,100	3,100	3,200
Grante nga ndihma nderkombetare me llogari ne thesar	0	0	0
Shitja e aseteve financiare	0	0	0
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve	0	0	0
Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0
Të ardhura te tjera si agjent tatimor për taksën e pulles	371	371	372
Të ardhura nga garanci financiare	0	0	0
Të ardhura nga donacione/sponsorizime	0	0	0
Grante nga ndihma nderkombetare me llogari jashtë thesari	2,479	770	0

Të ardhurat e tjera zënë 3% të totalit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër. Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave të tjera e zënë të ardhurat nga kundravajtjet administrative (Gjobat) me 67 % të totalit të të ardhurave të tjera, duke vijuar me Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë 22%, Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime me 10%, dhe të ardhura te tjera 1 %.



Grafik 13 Pesha e të ardhurave të tjera sipas llojit

Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”: Bazuar në Nenin 6.b, ”Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta”.

Bazuar në Nenin 10, “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektive tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendor etj.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kontratave vijuese dhe kapaciteteve brenda juridiksionit të Bashkisë dhe dhënies me qera të objekteve të cilave i ka përfunduar ose i përfundon afati i kontratës, sipas miratimeve me vendim të këshillit bashkiak.

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore, aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë. Për zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve nuk janë parashikuar të ardhura.

Të ardhura nga donacionet

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marrëveshjet për sponsorizime, nga organizata jo qeveritare, subjekte shtetërore / private dhe individë.

Të ardhura dhe grantet ndërkombëtare

Grant/ndihmë- janë të ardhura të përfituara në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, e cila përdoret për financimin e veprimtarive në përputhje me politika të caktuara dhe që jepen mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse nga institucione financiare, organizma të huaj, qeveri të vendeve të tjera etj.dhe marrëveshje për grante ndërkombëtare sipas aplikimeve në thirrje të ndryshme .

Ministria përgjegjëse për financat kontrollon, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat, kreditë dhe grantet. NJQP-të paraqesin, pranë strukturës përgjegjëse për buxhetin, kërkesat për përfshirje në programin buxhetor afatmesëm (PBA), në të cilin identifikohen me kod të veçantë produkti sipas klasifikimit funksional buxhetor.

NJQP-të janë të detyruara t'i raportojnë ministrisë përgjegjëse për financat të dhënat e kërkuara të financimeve të huaja, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave, kredive dhe granteve me financim të huaj do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor që miratohet në Këshill Bashkiak.

Projektet me sistem të pjesshëm Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara për çdo projekt të financimit të huaj.

Bashkia në vijim të marrëveshjeve të lidhura dhe projekteve në vazhdim, ka të parashikuara në vitin 2024 shumën 2,479 mijë lekë nga projekti TVESA.

Projektet me sistem të plotë Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transitimit nga llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara, për çdo projekt të financimit të huaj në Bankën e Shqipërisë.

Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi i objektivave
- b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të tregohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dhe raportimi.
- h) Hartimi i planit të veprimit.

Regjistri i Riskut								
Nr	Përshkrimi i riskut	Risku para kontrollit	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontroleve ekzistuese	Nevoja për kontrole të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <= i pandryshuar =)
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1.	Mungesa e informacionit në terren	mesëm-ulët	Monitorime në terren nga inspektorët e zonës	ulët-ulët	po	Përgatitja e planit të punës për evidentim	Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrenguese	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Agjencia Shtetërore e Kadastres	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për informacion	Mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Agjencia Shtetërore e Kadastres	Agjencia e Shtetërore e Kadastres	Pandryshuar
3	Mungesa e informacionit nga	ulët-ulët	Kërkesa shkresore për informacion	ulët-ulët	po	Bashkepunimi me QKB-ne	QKR dhe Sektori i Regjistrimit	Përmirësuar

	QKB-ja							
4	Dokumenacion i plotë arkivor	ulët-ulët	Pasurimi me dokumentacion i pronësie	ulët-ulët	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Sektori i Regjistrimit Sektori i Kontrollit	Pandryshuar
5	Mungesa e informacionit në Njësitë Administrative	mesëm - ulët	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	ulët - ulët	po	Grupe të zgjeruara pëtvendimim e taksapaguesve	Njësitë Administrative dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
6	Mungesë informacioni për tokën bujqesore	mesëm - mesëm	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	mesëm - ulët	po	Bashkepuni me Drejtorinë e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Sektori Familjar	Pandryshuar
7	Shërbim pranë taksapaguesit	ulët - ulët	Rritja e mundësisë së arkëtimit pranë taksapaguesit nga ana e Agjentit Tatimor	ulët - ulët	jo	Mbështetje nga Ujësjetllës – Kanalizime sh.a	Agjenti Tatimor Ujësjetllës – Kanalizime sh.a dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
8	Dokumenacion bazues për taksim	mesëm - mesëm	Pasurimi me dokumentacion i pronësie	mesëm - ulët	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Zyra me një ndalesë dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
9	Ndjekja e masave shtrënguese	mesëm - mesëm	Njoftime në terren dhe me postë	mesëm - mesëm	po	Përgatitja e planveprimit	Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrënguese	Pandryshuar
10	Rakordimi i shpejtë i pagesave	ulët - ulët	Marrja në kohe e arketimeve me banke nga Dega e Thesarit	ulët-ulët	jo	Plan veprimi për rakordimin e të ardhurave	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
11	Përmirësimi i marëdhënies taksapagues – taksambledhës	mesëm - ulët	Sensibilizim dhe njoftime të afateve në media, propozim për taksa të përbalueshme dhe incentive, ndarje e detyrimeve në këste, etj.	ulët-ulët	jo	Trajtimi dhe interpretimi i kërkesave nga subjektet	Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit Sektori familjar	Përmirësuar
12	Realizimi i të ardhurave nga bizneset	ulët-ulët	Analiza mujore sipas zërave	ulët-ulët	po	Shqyrtimi i zërave sipas ecuresisë	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
13	Realizimi i të ardhurave nga familjet	mesëm - ulët	Analiza sipas Njësive Administrative	ulët-ulët	po	Shqyrtimi i sipas ecuresisë	Sektori familjar Sektori i Kontabilizimit dhe	Përmirësuar




							Rakordimit	
14	Realizimi i të ardhurave nga agjentë tatimorë	mesëm - ulët	Analiza mujore	ulët-ulët	po	Analizë për çdo agjent	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
15	Realizimi i të ardhurave nga Drejtori të tjera dhe Institucione varësie	ulët-mesëm	Analiza mujore	ulët-mesëm	po	Analiza sipas Drejtorive të tjera dhe institucioneve të varëse sipas zërave	Drejtoritë e tjera dhe Institucionet e varësisë të bashkisë, sipas të ardhurave që planifikohet të realizojnë Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
16	Azhornimi i vazhdueshëm i programit të kompjuterizuar	ulët-ulët	Bashkëpunim me programuesit për azhornimin e te dhenave në program.	ulët-ulët	po	Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program	Programuesit e Sistemit Sektori i regjistrimit dhe vlerësimit Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit Sektori i familjar Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrenguese	Përmirësuar
17	Dhënia e informacionit për taksapaguesit	ulët-ulët	Dhënie e shërbimit pranë sportleve	ulët-ulët	jo	Kkoha e dhenies përgjigje kërkesave të taksapaguesve	Zyra me Një ndalesë Drejtoria Ardhurave	Përmirësuar
18	Llogaritje e shpejtë e detyrimeve	ulët-ulët	Përfshirje e llogartjes së detyrimit në sistemin e kompjuterizuar dhe on line	ulët-ulët	po	Plotesimi i kërkesave të taksapaguesve	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe llogaritjes së detyrimit Sektori familjar	Pandryshuar
19	Evidentimi i shpejtë i pagesave	mesëm-ulët	Kontabilizimi i shpejtë i të ardhurave	ulët-ulët	jo	Monitorimi i kohës për emetimin e evidencave	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
20	Shërbime dhe veprime online për taksapaguesin	mesëm-ulët	Bashkëpunim me programuesit	ulët-ulët	po	Plotesimi i kërkesave të taksapaguesve	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe drejtoria	Përmirësuar
21	Përditësim me standartet e reja ligjore	ulët-ulët	Shyrtimi i njohurive dhe evidentimi i ndryshimeve	ulët-ulët	po	Krahasimi dhe diskutimi periodik mbi njohuritë	Drejtoria Ardhurave	Pandryshuar

22	Njohuri mbi sistemet on-line të instaluara	ulët- ulët	Shqyrtimi dhe krahasimi mes nevojave dhe programeve on-line	ulët- ulët	po	Perditesime periodike mbi nevojën për zgjerim të njohurive	Drejtoria Ardhurave	Pandryshuar
23	Njohje me eksperiencë të ngjashme dhe trainime profesionale	mesëm- ulët	Trainime dhe diskutime mbi to	ulët- ulët	po	Diskutime dhe konstatime	Drejtoria Ardhurave	Përmirësuar

Drejtoria e të Ardhurave

Drejtor

Gjergj Kurti



KRYETAR

Bardh SPAHIA

Me vendim delegimi

ZV/KRYETAR

Tonin DEPAJ

